



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.649/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, me seli në Obiliq për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa Anr.649/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, ndërsa subjektit politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 650.00 euro (gjashtëqindpesëdhjetë), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

II. DETYROHET subjekti politik Iniciativa Qytetare për Obiliq, që gjobën e shqiptuar si në pikën **-I-** të dispozitivit të këtij vendimi ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Më datë 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.649/2021 të datës 18.10.2021, të paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë në të cilat pretendon se Burim Gërguri, kandidat për Kuvend Komunal në komunën e Obiliqit nga radhët e subjektit politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, në ditën e zgjedhjeve me datë 17.10.2021, përmes rrjetit social Facebook ka sponsorizuar dy postime me anë të cilave ka kërkuar nga qytetarët që ta votojnë duke ndikuar kështu në mënyrën e votimit, andaj me këtë postim kandidati Burim Gërguri ka tejkalluar periudhën kohore për fushatë zgjedhore. Në mbështetje të pretendimeve të tyre Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova ka bashkangjitur si dëshmi fotografi të printuar të shkeljes së supozuar sipas ankesës.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se këto veprime bien ndesh me Planin Operacional për Organizmin e Zgjedhjeve Lokale, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullën Zgjedhore 13/2013. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provave materiale.

PZAP, më datë 18.10.2021 i ka paraqitur subjektit politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, kërkesë për përgjigje lidhur me ankesën Anr.649/2021 me të cilën ka kërkuar që të përgjigjet deri më datë 19.10.2021 në ora 09:00.

Subjekti politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, me datë 19.10.2021 ka paraqitur pranë PZAP-së përgjigje në ankesë me të cilën i ka kundërshtuar pretendimet e ankuesit duke theksuar se në ditën e 17 tetorit 2021 nuk është bërë asnjë shkelje apo tentim për thyerje të heshtjes zgjedhore ashtu që nuk ka rënë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht nenit 8.1 pika a), b), d), e), f) dhe g) ngase nuk ka sponsorizuar në faqe lajme apo thirrje për votim dhe se postimet në fjalë janë bërë me datë 17 shtator 2021 dhe 9 tetor 2021. Në mbështetje të pretendimeve të tij parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka bashkangjitur tri foto të printuara të postimeve të bëra nga ana e tij.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shqyrtimi të shkresave të lëndës ka konstatuar se subjekti politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, përkatësisht kandidati për Kuvend Komunal në Komunën e Obiliqit, Burim Gërguri gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin social “Facebook” ka bërë fushatë zgjedhore ashtu që përmes rrjetit social “Facebook” ka sponsorizuar një postim ku shihet edhe fotoja e tij me numër të subjektit politik, slloganin e tyre si dhe numri i të njëjtit për kuvend komunal, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) e LZP-së, e cila përcakton *“Njëzet e katër (24) orë para hapjes së Qendrës te Votimit për hedhjen e votës, e deri ne mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidateve te tyre u ndalohe bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, me datë 18.10.2021 ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara duke hasur në një shkelje për faktin se në llogarinë e Facebook-ut, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës për postimin e kandidatit për kuvend komunal në komunën e Obiliqit, Burim Gërguri, në ditën e heshtjes zgjedhore, njëra nga dy postimet e

paraqitura si në ankesë është larguar ndërsa tjetra me titull “Bashkë me qytetarët jemi të parët për Obiliqin” në të cilën shihet fotoja e madhe e kandidatit ka qenë ende aktive dhe kishte sponsorizim.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin se ankesa e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova është e pabazuar ngase kandidati Burim Gërguri nuk ka pasur aktive dhe të sponsorizuara postimet e pretenduara në ankesë në ditën e heshtjes zgjedhore, Paneli i vlerësoi si të pabazuara ngase me dispozita ligjore, subjekteve politike apo kandidatëve të tyre iu ndalohej të bëjnë fushatë, në një mënyrë apo tjetër 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit e se ka qenë ende aktive njëri nga postimet dhe i sponsorizuar është vërtetuar pas verifikimeve të bëra nga PZAP, andaj si e tillë konsiderohet se është bërë shkelje e heshtjes zgjedhore prandaj edhe ankesa e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova është e bazuar.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, gjithashtu si rrethanë paneli mori faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoja Iniciativa Qytetare për Obiliqin, nuk ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme dhe nuk ka marrë mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore si dhe faktin se subjekti në fjalë ka marrë pjesë në zgjedhje vetëm në një Komunë të Republikës së Kosovës dhe faktin se kandidati në fjalë ka larguar njërin nga postimet që është objekt i pretendimeve ankimore, e të cilat rrethana kanë ndikuar në lehtësimin e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se gjoja e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi, nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekura në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.649/2021 më datë 20.10.2021

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

